




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/645
09/10/2020
Podujevë

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i datës 19.10.2017, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 20/07/2018, si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Podujevës, Drejtoria e Arsimit shpall:

KONKURS

Për mësimdhënës në Komunën e Podujevës për vitin shkollor 2020/2021

1. Një (1) mësimdhënës të edukatës figurative

Nr.	Shkolla	Vendi	Nr. orëve	I lirë/ zëvendësim	Deri
1	Shfmu "Kadri Kadriu"	Llaushë	8	I lirë	31/08/2021
2	Shfmu "Zahir Pajaziti"	Brainë	3		

- Kriteret e kualifikimit – Pikturë; Skulpturë; Grafikë:
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
 - Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor me 300 ECTS, kanë të drejtë konkurrimi;
 - Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar të nivelit master arsimor, sistemit katërvjeçar dhe baçelor katërvjeçar, mund të pranohet niveli baçelor trevjeçar për një vit shkollor.

2. Një (1) mësimdhënës të teknologjisë-informatikës

Nr.	Shkolla	Vendi	Nr. orëve	I lirë/ zëvendësim	Deri
1	Shfmu "Luigj Gurakuqi"	Batllavë	12	I lirë	31/08/2021

- Kriteret e kualifikimit – Teknologji/Informatikë; Matematikë/Informatikë:
- Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
- Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor me 300 ECTS, kanë të drejtë konkurrimi;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar të nivelit master arsimor, sistemit katërvjeçar dhe baçelor katërvjeçar, mund të pranohet niveli baçelor trevjeçar për një vit shkollor.

KUSHTET:

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra nr. 14 e komunës);
- Certifikata e lindjes;
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje);
- Dëshmi mbi kualifikimin (kopja e vërtetuar);
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse keni);
- Certifikatën që nuk jeni në hetime;
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranohen në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve).
- **Sqarim shtesë:**
 - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente;
 - Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT;
 - Në test/intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas U. A. (MASHT) nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 20/07/2018;
 - Testi/intervista me kandidatë për mësimdhënës mbahet sipas orarit i cili do të publikohet në tabelën e shpalljeve të Komunës së Podujevës (në hyrje të objektit të komunës);
 - Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2020-2021. Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave pritëse;
 - Dokumentet nuk kthehen.
- **Afati i konkursit**
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, pra deri më datë 23/10/2020.

Drejtori

Agim Blakori, MSc.

